VENDIM
Nr.14, datë 28.2.2005

"PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 22.12.2004 "PËR LISTËN E DOKUMENTEVE TË LLOGARIDHËNIES SË DETYRUAR VJETORE DHE PERIODIKE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT"

Në mbështetje të shkronjës "k" të pikës 2 të nenit 14 dhe të pikës 2 të nenit 20 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve" dhe nenit 115 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Në udhëzimin nr.1, datë 22.12.2004 "Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore dhe periodike të shoqërive të sigurimit", raportimi i shoqërive të sigurimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për pasqyrat M-1D, M-5D, M-2, M-3, M-4, M-6, M-7 bëhet mujor dhe progresiv brenda datës 15 të muajit pasardhës.

2. Ky vendim t'i dërgohet për zbatim shoqërive të sigurimit.

Ky vendim hyn në fuqi më 28.2.2005.

KRYETARI I KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba